

## Çfarë duhet të dijnë prindërit dhe kujdestarët për

# INFLUENCERËT

Në epokën e sotme dixhitale, ndikuesit/influencerët e rrjeteve sociale luajnë një rol gjithnjë e më të rëndësishëm në formësimin e mendimeve, interesave dhe sjelljeve të fëmijëve tanë. Ndërsa shumë prej këtyre individëve mund të kenë një efekt pozitiv, kultura e ndikimit mund të paraqesë gjithashtu rreziqe të caktuara - të tilla si inkurajimi i konsumizmit (teoria se individët që konsumojnë mallra dhe shërbime në sasi të mëdha do të jenë më mirë se tjerët), ndikimi në vetë-vlerësim dhe mjegullimi i besueshmërisë. Për të ndihmuar në sigurimin e një mjedisi të sigurt në internet për të rinjtë, është jetike të ruani komunikim të hapur, të vendosni kufij të arsyeshem, të promovoni një imazh të shëndetshëm për veten dhe të mësoni shkrim-leximin e medias dixhitale. Udhëzuesi ynë gërmon thellësisht në këto të gjitha.

Cilat janë rreziqet?

### KONSUMERIZMI I RRIUR

Një mënyrë kryesore që influencersit të fitojnë para është përmes partneriteteve të markave dhe përbajtjes së sponsorizuar. Si rezultat, fëmijët që i ndjekin mund të ekspozohen ndaj një rryme të qëndrueshme reklamash: kjo mund të çojë në qëndrime materialiste, pritshmëri joreale dhe një dëshirë në rritje për të pasur produktet më të fundit. Shumë influencers kanë ndërtuar perandori të mëdha të markave rreth ndjekësve të mëdhenj dhe mbresëlënës.

### SHITJA E BUTË

Disa influencers nuk janë gjithmonë transparentë në lidhje me qëllimet prapa postimeve të tyre, duke mjegulluar linjat midis rekomandimeve të vërteta dhe promovimeve me pagesë - dhe të rinjtë ndonjëherë e kanë të vështirë të dallojnë përbajtjen autentike nga reklamimi. Shumë platforma të mëdha sociale kanë ndërmarrë hapa për ta bërë përbajtjen e sponsorizuar dhe reklamat, më të lehta për t'u identifikuar, por kjo mbetet një zonë shqetësuese.

### SHQETËSIMET RRETH PRIVATËSISË

Të frymëzuar nga influencersit e tyre të preferuar, fëmijët mund të fillojnë të ndajnë më shumë nga jeta e tyre në internet - gjë që mund të zbulojë informacione personale ose detaje rreth rutinës së tyre të përditshme. Kjo hapje mund t'i vërë ata në rrezik nga bullizmi kibernetik apo edhe për sjellje 'grabitqare'. Tutje përkeqësohet nga transmetimi i drejtpërdrejtë, i cili nuk u jep të rinjve kohë për të marrë parasysh pasojat e mundshme nga të folurit e tepërt.

### DUKE MINUAR VETËVLERËSIMIN

Shumë influencers ndajnë imazhet, videot dhe aktivitetet e tyre, të cilat shpesh kurohen dhe modifikohen me shumë kujdes për të paraqitur një version të idealizuar të jetës së tyre. Fëmijët që ndjekin këta ndikues mund të zhvillojnë pritshmëri të shtrembëruara në lidhje me imazhin e trupit dhe konceptin e bukurisë, gjë që mund të çojë në vetëbesim negativ dhe madje edhe në probleme të shëndetit mendor.

## KËSHILLË PËR PRINDËRIT & KUJDESTARËT

### VAZHDONI TË FLISNI

Bisedoni me fëmijën tuaj rreth përbajtjes që ai konsumon në mediat sociale dhe për influencersit që i pëlqejnë. Nxiti ata të mendojnë në mënyrë kritike për atë që shohin dhe dëgjojnë në internet dhe dëgjoni çdo shqetësim që mund të kenë. Mbajtja e kësaj linje komunikimi të hapur dhe të sinqertë mund ta ndihmojë fëmijën tuaj të marrë vendime të informuara se cilët individë ndjek dhe me çfarë përbajtje angazhohen.

### MBËSHTETNI NJË IMAZH PERSONAL TË SHËNDETSHËM

Përforconi vetëdijen e fëmijës suaj se, jeta reale zakonisht nuk është aq perfekte sa mund të duket në rrjetet sociale - dhe se si disa përbajtje (veçanërisht ajo e influencersve) shpesh kurohen, vihen në skenë ose modifikohen për t'u dukur më magjepsëse. Nëse është e mundur, theksoni shembuj të influencersve të tjerë që ndajnë materiale autentike, të lidhura, i cili pranon gjithashtu papërsosmëritë dhe vështirësitë e tyre.

### VENDOS DISA KUFIJ

Pajtohuni me kufijtë e përshtatshëm të moshës për përdorimin e rrjeteve sociale për fëmijën tuaj, duke përfshirë kufijtë kohorë dhe cilësimet e privatësisë (dy sistemet kryesore operative në pajisjet celulare, Android dhe iOS, i kanë të vendosura këto kontrole). Përpuni të mbani një sy në aktivitetin e fëmijës tuaj në internet dhe diskutoni rregullisht me ta, duke i kujtuar për rreziqet e mundshme që mund të lindin nga ndjekësit e ndikimit.

### NXITJA E SHKRIM-LEXIMIT MEDIATIK

Flisni me fëmijën tuaj për konceptet e përbajtjes së sponsorizuar, reklamave dhe paragjyqimeve të mundshme të influencersve. Mësojini ata të vlerësojnë në mënyrë kritike informacionin që u paraqitet në internet dhe të marrin në konsideratë arsyet e mundshme prapa krijimit të përbajtjes. Kjo mund t'i ndihmojë të rinjtë të zhvillojnë shkathtësitë për të marrë vendime më të shëndetshme për influencersit që zgjedhin të ndjekin dhe për përbajtjen që ata konsumojnë.

# PENKOS

## Parents Education Network of Kosova

Përkthim dhe përshtatje

